



VENDIM

Nr. 195, Datë 30.12.2016

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT TË ERE-S NR 115, DATË 07.08.2016, MBI PËRCAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DERI NË 30 QERSHOR 2017

Në mbështetje të neneve 16, dhe 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Vendimit nr. 449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike” dhe nenit 8, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr.115, datë 07.08.2016, Bordi i ERE ka vendosur të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në 31.12.2016.
- Me Vendimin nr. 449, datë 15.06.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.”
- Referuar pjesës II, të VKM nr. 449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave, ERE përcakton Kushtet dhe procedurat për përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM nr. 449, datë 15.06.2016. Në përputhje me këtë përcaktim gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 do të përpunohen Kushtet dhe procedurat për përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit.
- Në pjesën III, të VKM nr. 449, datë 15.06.2016, përcaktohet se deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij Vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të mundësisë së fundit.

- Me VKM nr.244, datë 30.03.2016 janë miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”
- Në VKM nr. 244, datë 30.03.2016 është parashikuar se :*Detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjerë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimit të ERE-s nr 115, datë 07.08.2016, deri në 30 Qershor 2017.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.